

VENDIM
Nr. 528, datë 25.7.2019

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË TË PRONËS ME EMËRTIMIN “QENDRA E
SHËRBIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me emërtimin “Qendra e shërbimit dhe administrimit të mjeteve të transportit”, sipas formularit bashkëlidhur vendimit nr. 79, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar”.

2. Vendimi nr. 79, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama